



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Up1 Nr.03-279

19.05.2022

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 20 dhe nenit 23 paragrafi 1 alineja 1 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13,13/14,44/14, 101/14, 1S2/14, 42/16, 132/17, 168/18, 24B/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 53 paragrafi 2 të njëjtit Ligj, pika 4 e Udhëzimit për caktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave (teksti i konsoliduar) numri arkivor 01-6039/1 nga 20.10.2015, Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të programit, numri arkivor 10-3262/1 nga 26.08.2022, dhe në pajtim me Konkluzionin nr.02-3436/5 nga 16.09.2022, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në Mbledhjen e 35-të, të mbajtur më 16.09.2022, e miratoi këtë

Vendim

për ndërmarrjen e masës— paralajmërimi publik

1 PUBLIKISHT I TËRHIQET VËREJTJA Shoqërisë Radiodifuzive Tregtare (SHRT) KOMPANI 21 - M SHPKNJP Shkup, për shkak të shkeljes së nenit 53 paragrafi 2 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (LSHMAAV), në atë mënyrë që në kuadër të servisit të saj programor të televizionit, më 5 gusht 2022, në kuadër të tri edicioneve të ndryshme të emisionit argëtues-informativ "Në fokus", është transmetuar e njëjta shtojcë për "Bushit resort & spa Shkup" me nxitje të drejtpërdrejtë për të blerë një pjesë të shërbimeve të saj hotelierike, që është komunikim komercial audiovizuel i fshehur.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të programit, numri arkivor 10-3262/1 nga 26.08.2022, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi si Shtojca nr.1.

2. URDHËROHET SHRT KOMPANI 21 - M SHPKNJP Shkup, që menjëherë pas marrjes së këtij vendimi, ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV-së.

3. Të kryehet mbikëqyrja kontrolluese, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i përmendur në pikën 1 të këtij vendimi ka vepruar sipas vendimit.

4 Ky Vendim është i formës së prerë, dhe si ditë e miratimit konsiderohet dita e verifikimit të tij në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

A r s y e t i m i

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAA-së është kompetente për të kryer mbikëqyrjen (monitorimin) programor të programeve të radiodifuzerëve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, si dhe të pakove programore të ritransmetuara nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike për sa i përket respektimit të dispozitave të këtij ligji, lejeve, vërtetimeve të lëshuara të regjistrimit, akteve nënligjore dhe akteve të tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 alineja 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - vendim për paralajmërim publik në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV-së dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të të njëjtit Ligj, si dhe kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me lejet dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Neni 53 paragrafi 2 të LSHMAAV-së përcakton se nuk lejohen komunikimet e fshehta komerciale audiovizuele.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia përmes Sektorit për Çështje Programore, më 26 gusht 2022, ka kryer mbikëqyrjen (monitorimin) e rregullt programor të servisit programor të televizionit të SHRT KOMPANI 21 - M SHPKNJP Shkup, të transmetuar më 5 gusht 2022, në nivel shtetëror, në të cilin ka konstatuar

shkelje të nenit 53 paragrafi 2 të LSHMAA-së (komunikime të palejuara të fshehta audiovizuale komerciale), gjegjësisht nga mbikëqyrja ka konstatuar se në tërësi të audiovizuale të tri edicioneve të ndryshme (reprizave) nga emisioni argëtues-informativ - "Në fokus", është transmetuar shtojca e njëjtë dhjetëminutëshe për shërbimet hotelierike të "Bushit resort & spa Shkup". Në shtojcën e posaçme për "Bushit resort & spa Shkup", si vizualisht ashtu edhe verbalisht, është bërë rekomandimi i veçantë promovues për një pjesë të shërbimeve hotelierike, gjegjësisht është transmetuar komunikimi i fshehtë audiovizuel komercial, është bërë shkelja nga pika 1 e këtij vendimi, të përcaktuar në mënyrë të detajuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, numri arkivor 10-3262/1 nga 26.08.2022, që është pjesë përbërëse e këtij Vendimi si Shtojcë nr. 1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 3 të LSHMAA-së, Këshilli i Agjencisë SHRT KOMPANI 21 - M SHPKNJP Shkup, më 29.08.2022, dërgoi Shkresë, numri arkivor 10-3262/2 nga 29.08.2022, me të cilën dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të programit, numri arkivor 10-3262/1 nga 26.08.2022, me qëllim brenda 7 (shtatë) ditë pune nga dita e marrjes së shkresës, në Këshillin e Agjencisë të dorëzojë deklaratë në formë me shkrim për shkeljen e bërë të dispozitave të LSHMAAV-së. Shkresa është marrë siç duhet më 29.08.2022. Në afatin e paraparë (përkatësisht më 01.09.2022, SHRT KOMPANI 21 - M SHPKNJP Shkup, Agjencisë i ka dorëzuar deklaratën me shkrim, numri arkivor 10-3261/3 nga 01.09.2022, Këshilli i Agjencisë në mbledhjen e mbajtur më 16.09.2022, ka shqyrtuar raportin me shkrim dhe shkresën e dorëzuar — përgjigjen nga SHRT KOMPANI 21 - M SHPKNJP Shkup dhe konkludoi që SHRT KOMPANI 21 - M SHPKNJP Shkup t'i shqiptohet masa - paralajmërimi publik.

Rrjedhimisht, në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 20 dhe nenit 23 paragrafi 1 alineja 1 të LSHMAAV-së, dhe në lidhje me nenin 53 paragrafi 2 të të njëjtit Ligj, pika 4 e Udhëzimit për caktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave (teksti i konsoliduar), numri arkivor 01-6039/1 nga 20.10.2015. Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të programit, numri arkivor 10-3262/1 nga 26.08.2022, për shkak të mosrespektimit të konstatuar të dispozitave të LSHMAA-së të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, Këshilli i Agjencisë në Mbledhjen e 35-të, të mbajtur më 16.09.2022, në pajtim me Konkluzionin, numri arkivor 02-3436/5 nga 16.09.2022, miratoi vendim me të cilin publikisht paralajmërohet SHRT KOMPANI 21 - M SHPKNJP Shkup dhe urdhërohet menjëherë pas marrjes së vendimit për të harmonizuar punën e tij me dispozitat e LSHMAAV-së. Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolluese, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, ka vepruar sipas vendimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafët 1 dhe 2 të LSHMAAV-së, ky vendim është i formës së prerë dhe kundër tij radiodifuzeri mund të parashtrojë padi për iniciimin e kontestit administrativ përpara gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ parashtrohet brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

Në bazë të së lartpërmendurës, u miratua vendimi si në dispozitiv.

Shtojca (1):

- 1) Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të programit, numri arkivor 10-3262/1 nga 26.08.2022.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale,
Kryetar i Këshillit,
Llazo PETRUSHEVSKI, dv**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi radiodifuzeri mund të parashtrojë padi për iniciimin e kontestit administrativ përpara gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ parashtrohet brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

Dorëzuar:

- SHRT KOMPANI 21 - M SHPKNJP Shkup;
- Drejtorëve të SHRT KOMPANI 21 - M SHPKNJP Shkup;
- Personit përgjegjës të programit në SHRT KOMPANI 21 - M SHPKNJP Shkup:
- Sektorit për Çështje Juridike dhe Prokurime Publike;
- Sektorit për Çështje të Programit; dhe
- Personave të emëruar në Agjencinë për Mbajtjen e Zyrës së Regjistrimit Up1.

Drejtuar: dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele

Në bazë të nenit 28 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20 dhe 77/21), dorëzohet

RAPORTI ME SHKRIM PËR MBIKËQYRJEN E KRYER TË PROGRAMIT

1. Lloji i mbikëqyrjes: I rregullt;
2. Subjekti i mbikëqyrjes: Shoqëria Radiodifuzive Tregtare (SHRT) KOMPANI 21 - M SHPKNJP Shkup;
3. Periudha e përfshirë me mbikëqyrjen: 5 gusht 2022;
4. Data e kryerjes së mbikëqyrjes: 26 gusht 2022;
5. Lënda e mbikëqyrjes:
 - Neni 50 paragrafi 3 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (mbrojtja e personave të mitur nga programet që mund të dëmtojnë zhvillimin e tyre fizik, psikik ose moral),
 - Rregullorja për mbrojtjen e personave të mitur ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 172/14),
 - Nenet 53, 54, 55, 98, 99, 100 dhe 101 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (rregullat për transmetimin e komunikimeve komerciale audiovizuele),
 - Udhëzimi për zbatimin e dispozitave për produktet e plasuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 201/14),
 - Rregullorja për sponsorim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 40/15),
 - Rregullorja për teknikat e reja reklamuese ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.56/15),
 - Neni 52 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (detyrime gjatë sigurimit të kuizeve ose formave tjera të pjesëmarrjes në shpërblime),
 - Neni 93 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (shfrytëzimi i shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votim telefonik);
 - Rregullorja për programet me pjesëmarrjen në shpërblime dhe për shfrytëzimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.185/14),
 - Neni 94 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (transmetimi i lojërave të fatit).

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

6. Masa e shqiptuar paraprakisht: /

7. Konstatimet e mbikëqyrjes:

Me mbikëqyrjen e rregullt programore të servisit televiziv të programit për SHRT KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, transmetuar më 5 gusht 2022, në nivelin shtetëror, është konstatuar shkelja e nenit 53, paragrafi 2 (komunikimet e palejuara të fshehta audiovizuele komerciale) të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele.

Në tërësitë audiovizuele të tri edicioneve të ndryshme (reprizave) nga emisioni argëtues-informativ - "Në fokus", është transmetuar shtojca e njëjtë dhjetëminutëshe për shërbimet hotelierike të "Bushi resort & spa Shkup"

5 gusht 2022

Titulli i emisionit	Periodha e transmetimit		Përshkrimi i shkeljes
	Fillimi	Fundi	
Në fokus	02:14:25	03:25:30	Përmes shtojcës së veçantë, në kuadër të tërësisë argëtuese-informative të emisionit, u bë komunikimi i fshehtë komercial audiovizuel për "Bushi resort & spa Shkup";
	11:00:33	11:26:30	
	23:24:00	23:57:44	

Në shtojcën e posaçme për "Bushi resort & spa Shkup", si vizualisht ashtu edhe verbalisht, është bërë rekomandimi i veçantë promovues për një pjesë të shërbimeve hotelierike, gjegjësisht është transmetuar komunikimi i fshehtë audiovizuel komercial. Nxitja e drejtpërdrejtë që ato shërbime të blihen përmbahet në shprehjet e mëposhtme të udhëheqësve të emisionit (citate):

- *"Në Shkup ka shumë vende ku ofrojnë meny interesante, meny të mira për mëngjes. (...) Por, nga sot ky problem zgjidhet, drejtpërdrejt te "Bushi". Ashtu që Valoni, kur familja jote do të vijë nga Gostivari, pse jo, mund t'i sjellësh këtu dhe të hani mëngjes, drekë apo darkë";*

- *"Mendoj se as në Stamboll një super shërbim si ai që ishte më parë, besoj se edhe shikuesit panë, nuk mund të gjendet. Dhe, ku tjetër, përveç te "Bushi". Ashtu që të gjithë ju që dëshironi të hani një mëngjes të këthillë si unë dhe Valoni, detyrimisht duhet të vini këtu dhe ta shuani mallin e Stambollit, Turqisë. *;*

"ShkHpi nuk është se ka shumë vende ashtu të përshtatshme ku ofrojnë meni interesante, mënu të bukura për mëngjes, Por, qëngasot ky është një problem i zgjidhur drejtpërdrejt te "BUSHI". Kështu që Valoni, edhe li kur të vije familja yte nga Gostivari, pse jo, mund li sjellësh këtu e ta shijoni një mëngjes, drekë ose darkë,";

* "Unë mendoj që as në Stamboll kështu si më parë nuk mund të gjendet, besoj se edhe shikuesit panë edhe s/Jikzefit, nuk mundem më gjel. E ku ljetë, veq në "BUSHI". I ëshuqë, krejt jri që doni me

- "Zgjidhje më të mire që më ke sjellë te "Bushit" nuk ke bërë tri vitet e fundit.",
- „Unë dhe Flora, duke shëtitur nëpër çarshi, vendosëm të shkojmë për të ngrënë te "Bushit resort"- vërtet ia vlenë.*,"
- "Ejani edhe ju te "Bushit" dhe hani ushqimet më të mira dhe mëngjeset që ofrohen në vendin tone".",

8. Pëshkrimi i shkeljes:

Në kundërshtim me nenin 53 paragrafi 2 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, servisi televiziv të programit SHRT KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, më 5 gusht 2022 — në kuadër të tri edicioneve të ndryshme të emisionit argëtues-informativ "Në fokus" ka transmetuar të njëjtën shtojcë për "Bushit resort & spa Shkup" me nxitje të drejtpërdrejtë për të blerë një pjesë të shërbimeve të tij të hotelierisë, e cila është komunikim i fshehtë audiovizuel komercial.

9. Propozim-masë:

Këshilli i Agjencisë të miratojë vendim për shqiptimin e masës paralajmërimi publik i Shoqërisë Radiodifuzive Tregtare KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, dhe në pajtim me pikën 4 të Udhëzimit për caktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave nr. 01-6039/1 nga 20.10.2015, ta urdhërojë - menjëherë pas marrjes së vendimit - të harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale; dhe

Të kryhet mbikëqyrja kontrolluese për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (radiodifuzeri) ka vepruar sipas paralajmërimit (të plotë, pjesërisht ose nuk ka vepruar), pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin e veçantë (vendim), të miratuar nga Këshilli i Agjencisë.

shiju një lëngjes të tillë si unë dhe Vaioni, duhet patjetër në ardhë të (u edhe me hek pak mallin STAMBOL LET, e Turqisë.",

3 "Përzgjedhje në të mirë se sa kjo që m'ke për të "BUSHI" nuk ke bërë këto 3 vitet e fundit.";

* "Unë dhe Flora duke bërë xhiro në qarsli, thamë të shkojmë të hamë diqka në "BUSHI Resort". Me të vërtetë ia vlenë.";

"Hajdeni edhe ju te "BUSHI" dhe shijoni ushqimet dhe mëngjeset më të mira që ofrohen në vendin